

Në Budva u mbajt takimi për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të miturve

07.07.2015 – Me përkrahje të Këshillit Evropian, përfaqësues nga Komisioni rregullator për komunikim të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencia për komunikime elektronike e Malit të Zi, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e Maqedonisë dhe Trupi rregullator për komunikime elektronike i Sërbisë, më 6 dhe 7 korik në Budva mbajtën takim dedikuar thellimit të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të miturve.

Në këtë takim të pranishmit, së bashku me ekspertet nga Slovenija dhe Krocia, shkëmbyen përvoja tyre lidhur me rregullimin e kësaj fushe, me theks të veçantë klasifikimin dhe etiketimin e reality show të cilët kanë qasje në ofertat e televizioneve të këtyre shteteve.

U diskutua edhe gatishmëria për vazhdimin e bashkëpunimit me qëllim mbrojtjen e të miturve në mediat elektronike, me theks të veçantë parandalimi i shkeljes të standardeve, përparimi i monitorimit të përmbajtjeve dhe koordinimi i aktiviteteve.

Këshilli Evropian do të përkrahe edhe aktivitete të mëtutjeshme drejtuar forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare.